

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës – Katedra e Ekonomiksit
Titulli i lëndës:	Ekonometri II
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	3
Numri i orëve në javë:	4
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	n/a
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	
	<p><i>Ekonometria II është një trajtim më i avancuar i hulumtimit empirik të problemeve ekonomike duke përdorur metodologjinë e regresionit. Lenda shtjellon aplikimin e metodave statistikore për testimin dhe vlerësimin e hipotezave ekonomike. Temat kryesore të mbuluara përfshijnë rishikimin e ceshtjeve mbi analizen e regresionit dhe procesin e ekonometrise, ku theksi do të vihet në modelet ML (MPM). Poashtu, përdorimi i 'software'-ve statistikore dhe ekonometrik për të analizuar të dhënat, psh. Stata dhe Microfit, është pjesë perberese e lëndës së shtjelluar.</i></p> <p><i>*Parakusht për këtë lëndë është njohuria e mëparshme në Ekonometri I.</i></p>
Qëllimet e lëndës:	<p><i>Qëllimet e kësaj lënde janë: ofrimi i një paraqitjeje më të detajuar të koncepteve ekonometrike; ofrimi i bazave të analizës ekonometrike duke u fokusuar në metodologjinë e regresionit shumë-faktorial (kryesisht metoden ML); ofrimi i të kuptuarit gjithpërfshirës të analizës ekonometrike mbi problemet ekonomike; përfitimi i njohurive mbi një paketë kompjuterike për analize të të dhënave dhe njohuritë për të përpiluar Projektin Final ku studenti pritët që të ndërtojë një model ekonometrik me një lidhje funksionale që është konsistente me teorinë, të mbledhë të dhënat përkatëse, të bëjë vlerësimin e modelit, të identifikojë problemet e mundshme statistikore, të bëjë interpretimin e rezultateve. Projekti final duhet të përmbajë një përmbledhje të çështjes që është duke u hulumtuar, përcaktimin e objektivave dhe hipotezave</i></p>

	<i>për të testuar; prezantimin e teorisë dhe shqyrtimit të aspekteve përkatëse teorike; shtjellimi i problematikes ne aspektin e nderlidhjeve empirike; specifikimi i modelit për t'u vlerësuar, të dhënat dhe burimi i tyre; prezantimi i rezultateve të vlerësimit, dhe statistika përmbledhëse; statistikat e testeve diagnostike, diskutimi i testeve dhe procedurave për zgjidhjen e problemeve ekonometrike; konkluzionet, implikimi i rezultateve ne teori dhe politika ekonomike; krahasim me rezultatet e tjera empirike.</i>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<i>Te kuptuarit e koncepteve me te avancuara ne ekonometri; formulimi i nje modeli empirik; mbledhja e të dhënave, interpretimi, organizimi, dhe analiza e regresionit e aplikuar ne nje problematike ekonomike; pervesimi i pakos kompjuterike per ekonometri. Ne Projektin Final, studenti pritet qe te ndërtojë një model ekonometrik me një lidhje funksionale që është konsistente me teorine, të mbledhë të dhënat përkatëse, te beje vlerësimin e modelit, te identifikojë problemet e mundshme statistikore, te beje interpretimin e rezultateve.</i>
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<i>Në përputhje me statutin e UP-së 'Hasan Prishtina'.</i>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<i>Myslim Osmani, Metodat e Ekonometrise, Universiteti i Tiranës; Materiale nga Ligjeratat .</i>
<b>Literatura shtesë:</b>	<i>Liao, T.F. (1994), Interpreting Probability Models Logit, Probit, and Other Generalized Linear Models, SAGE Publications.</i>
<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	<i>Rishiqikmi i koncepteve kyce dhe procesi i hulumtimit ne ekonometri</i>
<b>Java e dytë:</b>	<i>Modeli i Probabilitetit Linear dhe vleresimi i modeleve ML</i>
<b>Java e tretë:</b>	<i>Modelet me ndryshore te varur 'dummy': Logit</i>
<b>Java e katërt:</b>	<i>Modelet me ndryshore te varur 'dummy': Probit</i>
<b>Java e pestë:</b>	<i>Projekti Final: Perzgjedhja e temave</i>
<b>Java e gjashtë:</b>	<i>Modelet Ologit dhe OProbit</i>
<b>Java e shtatë:</b>	<i>Modelet Tobit dhe modelet tjera ML</i>
<b>Java e tetë:</b>	<i>Tema te zgjedhura nga modelet me te dhena ne seri kohore</i>
<b>Java e nëntë:</b>	<i>Tema te zgjedhura nga modelet me te dhena panel</i>
<b>Java e dhjetë:</b>	<i>Projekti Final: Diskutime mbi temat</i>
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<i>Problemet tjera gjate vlersimit te modelit ekonometrik dhe</i>

	<i>metodat per zgjidhe</i>
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<i>Perdorimi i 'software'-ve ne ekonometri</i>
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	<i>Perdorimi i 'software'-ve ne ekonometri</i>
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	<i>Perpilimi i një punimi empirik</i>
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<i>Permbledhje</i>
